


Notere MAJLINDA LLESHI
Dhoma e Notereve Tirane
Rr" Sulejman Delvina"
Tel ++2234555
Nr 748 rep.
Nr 493 kol.



KONTRATE

PER SHITJEN E AKSIONEVE ME KUSHT

Ne Tirane, sot me daten 6/02/2012 (dymije e dymbedhete), perpara meje Noterit Majlinda Lleshi, me seli ne Tirane ne Rr" Sulejman Delvina" u paraqiten palet:

1. **Z. Jorgo MANO**, i biri i Koços i datelindjes 25.11.1960, lindur ne Gjirokastrër dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtës i leternjoftimit ID Nr 025176644, ne cilesine e Aksionarit me zoterim te 100 aksioneve, qe perfaqesojne 100% te kapitalit themeltarte Shoqerise „A.S.K Oil“sha“, te fituara me kontraten nr.2124 Rep./683 Kol., date 31.05.2011, te Noterise Tirane, *ketu dhe me poshte i quajtura Shitesi.*
2. Shoqeria **“HOXHA - XH” sh.p.k.**, e regjistruar me NIPT Nr K31809024P, me seli ne Tirane ne Rr" M. Ulqinaku", P.56, Nr 1/1, perfaqesuar nga **Z. Xhelal Hoxha**, i biri i Xhetanit i datelindjes 12.05.1948, lindur ne Diber dhe banues ne Paskuqan Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtës i leternjoftimit ID Nr 031060188, *ketu dhe me poshte i quajtura Bleresi.*

Palet e mesiperme, pasi jane njohur me dokumentacionin ligjor dhe teknik, kane rane dakort qe te lidhin kete Akt Marreveshje per arritjen e nenshkrimtit te kontratave te shitjes se aksioneve te shoqerise „A.S.K Oil“sha, NIPT K82109004K, si me poshte:

NENI 1.

Premisa te Akt Marreveshjes

- 1.1. Shoqeria „A.S.K Oil“sha eshte regjistruar prane QKR si Person juridik shoqeri aksionere. Aksionar i saj eshte **Jorgo Mano** me zoterim te 100 aksioneve, qe perfaqesojne 100% te kapitalit themeltarte Shoqerise, te fituara me kontraten „Per shitjen e aksioneve te shoqerise „A.S.K Oil“sha“, nr.2124 Rep./683 Kol., date 31.05.2011, te Noterise Tirane, Notere Majlinda Lleshi.
- 1.2. Shoqeria „A.S.K Oil“sha eshte nje prej kater ortakeve ne shoqerine „Bushtrica Energy 2009“sh.p.k, me NIPT K98505601E, me zoterim te 280 kuotave ne kete shoqeri dhe qe i takojne 28% te kapitalit themeltar te kesaj Shoqerie.
- 1.3. Shoqeria „Bushtrica Energy 2009“sh.p.k dhe Ministria e Ekonomise, Tregtise e Energjitikes kane lidhur „Kontrate Koncensionit e Formes „BOT“ (Nderim-Operim-Transferim) Per Nderimin e Hidrocentraleve ne Rrjedhen e Lumit Bushtrice, Rrethi i Librazhdit“, me nr.2829 Rep., nr.373 Kol., date 03.09.2009.



(Handwritten signatures of the parties and the notary)



te Noterise Tirane, sipas te ciles dhe sipas statutit te shoqerise „Bushtrica Energy 2009“shpk, ortaku Shoqeria „A.S.K Oil“sha detyrohet se do te ndertoje ne kaskaden e lumit Bushtrice, Librazhd, nje hidrocentral me fuqi te instaluar minimalisht 7,2 Mw/hour ne kuotat 820-596 metra mbi nivelin e detit.

- 1.4 Baza e aktivitetit te shoqerise „A.S.K Oil“sh.a do jete permbushja e detyrimeve te rrjedhura nga „Kontrate Koncensionit e Formes „BOT“ (Ndertim-Operim-Transferim) per Ndertimin e Hidrocentraleve ne Rrjedhen e Lumit Bushtrice, Rrethi i Librazhdit“, nr.2829 Rep., nr.373 Kol., date 03.09.2009; nga „Kontrate per Bashkepunim te Perkohshem te Shoqerive“, me nr.6067 Rep, nr.2607 Kol, dt.28.08.2009, Notere Shpresa-Gjoci, Tirane; nga statuti i Shoqerise „Bushtrica Energy 2009“sh.p.k; nga statuti i Shoqerise „A.S.K Oil“ sh.a; dhe nga cdo akt tjeter ligjor ne plotesim te akteve te sipercituarra dhe te kesaj Akt Marreveshje.

NENI 2.

Objekti i Akt Marreveshjes

- 1.1 Shitesit, me ane te kesaj Akt Marreveshje, merr persiper kalimin, me shperblim ne natyre, ne perfitim te zXhelal Hoxha te 70% te aksioneve, nga 100%, qe zoterohet ne Shoqerine „A.S.K Oil“sh.a, pas plotesimit te kushtit dhe sipas menyrave te percaktuara me poshte ne kete Akt Marreveshje.
- 1.2 Shitesit, me ane te kesaj Akt Marreveshje, merr persiper dorezimin tek bleresi te gjithe dokumentacionin perkates qe sherben dhe qe do te sherbeje ne funksion te permbushjes se detyrimeve perfshire projektin e krahut djathte
- 1.3 Bleresi, me ane te kesaj Akt Marreveshje, merr persiper plotesimin e te gjitha kushteve te vena ne kete Akt Marreveshje, sipas menyrave dhe grafikut te percaktuara me poshte.

NENI 3.

Kushtet Thelbesore te Akt Marreveshjes

1.1 Palet bien dakort qe kushtet per permbushjen e detyrimit te transferimit te 70%te aksioneve, nga 100%, te zoternara nga Shitesit ne Shoqerine „A.S.K Oil“sha ne favor te Bleresit, sipas radhes do te jene :

- 1.1.1 Bleresi prej momentit te nenshkruarit te kesaj Akt Marreveshje do te kryeje ne masen 100% vleren e plote te investimit (shprehur ne mjete monetare e materiale, fuqi punetore, makineri paisje, dhe te cdo forme tjeter kontributi), per ndertimin, instalimin, provimin, kolaudimin, marrjen e lejeve dhe venien ne shfrytezim te HEC-ve te shoqeris „A.S.K Oil“sha sipas detyrimeve te rrjedhura nga „Kontrate Koncensionit e Formes „BOT“ (Ndertim-Operim-Transferim) per Ndertimin e Hidrocentraleve ne Rrjedhen e Lumit Bushtrice, Librazhd“, Nr.2829 Rep., Nr.373 Kol., dt.03.09.2009; nga „Kontrate per Bashkepunim te Perkohshem te Shoqerive“, Nr.6067 Rep, Nr.2607 Kol, dt.28.08.2009; statuti i Shoqerise „Bushtrica Energy 2009“sh.p.k; nga cdo akt tjeter ne funksion te ketyre akteve. Vlerat e investimit, te shprehura ne „Kontrate Koncensionit e Formes „BOT“ (Ndertim-Operim-Transferim) per Ndertimin e Hidrocentraleve ne Rrjedhen e Lumit Bushtrice, Rrethi Librazhd“, Nr.2829 Rep., Nr.373 Kol., dt.03.09.2009, nuk konsiderohen si vlera perfundimtare te investimit. Vlera e investimit total do rezultojpas zbatimit te projektit te zbatimit deri perfundimin e plote te tij, bashke me ndryshimet qe do ti behen projektit. Bleresi do te kryeje



NENI 4. Afatet e Kryerjes se Investimit

4.1 Bleresi merr përsiper detyrimin që të kryejë investimin e plote për ndërtimin, instalimin dhe venien në shfrytëzim të HEC-ve të shoqërisë „A.S.K Oil“ sh.a brenda përcaktimeve të bërë sipas „Kontratës Koncensionale të Formës „BOT“ (Ndërtim-Operim-Transferim) për Ndërtimin e Hidrocentraleve në Rrjedhën e Lumit Bushtrice, Rrethi i Librazhdit“, me Nr.2829 Rep., Nr.373 Kol., datë 03.09.2009.

NENI 5. Mospërmbushja e Kushteve

5.1 Mospërmbushja në kohë e afateve të investimit e venies në shfrytëzim të HEC-ve detyron palët të paguajnë një penaltet. Kjo pasi nga një grup ekspertësh ligjorë e kontabël të bëjë vlerësimin në vend të dëmit të shkaktuar nga pala fajtoare. Masa e penaltetit do të jetë në vlerën e plote të investimit deri në atë moment.

Ky kusht do të jetë i vlefshëm dhe në rastin e lidhjes së Kontratës përfundimtare të shitjes së aksioneve,

Akt

Marreveshje, që do të jenë pjesë dhe e Kontratës së Shitjes me Rezervë të Aksioneve.

5.2 Penaltet e vena për shoqërinë „A.S.K Oil“ sh.a nga mospërmbushja e detyrimeve të rëndësura nga „Kontrata Koncensionale të Formës „BOT“ (Ndërtim-Operim-Transferim) për Ndërtimin e Hidrocentraleve në Rrjedhën e Lumit Bushtrice, Rrethi i Librazhdit“, nr.2829 Rep., nr.373 Kol., dt.03.09.2009, do të paguhet perkatesisht nga palët, sipas përgjegjësisë ligjore që kanë të dy palët në aktmarveshje. Në rast se palët nuk do të përmbushin këtë kusht, kjo Akt Marreveshje konsiderohet e zgjidhur dhe ngarkohen të 2 palët me pagimin e penalteteve të vena ndaj shoqërisë „A.S.K Oil“ sh.a si dhe me dëmet që janë shkaktuar nga mospërmbushja e detyrimit.

NENI 6. Zgjidhja e Akt Marreveshjes

6.1 Kontrata nuk mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga asnjëra palë. Nga ky kusht nuk përjashtohen rastet e parashikuara në nenet 3, 5 dhe 6 të kësaj Akt Marreveshje. Në këto raste kjo Akt Marreveshje do të konsiderohet e zgjidhur nëpërmjet një njoftimi që do të bëhet reciprokisht palëve.

6.2 Në rast të zgjidhjes së Akt Marreveshjes për çdo lloj shkak të pavarur nga z. Jorgo Mano, ky i fundit ka të drejtat si më poshtë:

6.2.1 Në rast se Bleresi, për shkak të pamundësisë të realizimit të investimit apo për shkak të tjera të cilat varen nga paaftësia e pamundësia e tij, nuk përmbush detyrimet e rëndësura nga Akt Marreveshja, atëherë Akt Marreveshja konsiderohet e zgjidhur. Kjo vlen për rastet kur aktmarveshja nuk është zbatuar pa shkak të forta ligjore, dhe madhore në këtë rast blerësi paguan penaltetet.

6.2.2 Në rastet e kryerjes të një vlerë të investimit dhe pamundësisë për përfundimin e plote të investimit sipas kushteve të kësaj Akt Marreveshje përsëri kjo Akt Marreveshje përsëri mbetet për të zgjidhur. Sëparimisht se kur aktmarveshja nuk realizohet për shkak të pajustificuara ligjore dhe vlera e investimit i kalon 35% atëherë vlera e kthimit të investimit të bërë nga blerësi do të bëhet në masën e plote me një kohë jo më shumë se palët bënë dakort me njëri tjetrin. Ky kusht është



rasën kur Bleresi ka realizuar investime në vlerë më shumë se 35% të vlerës totale të investimit sipas detyrimit të shoqërisë „A.S.K Oil“ sh.a të rjedhur nga „Kontratë Koncensionale e Fornimit „BOT“ (Nderim-Operim-Transferim) Për Nderimin e Hidrocentraleve në Rrjedhën e Lumit Bushtrica, Rrethi i Librazhdit“, me nr.2829 Rep., nr.373 Kol., datë 03.09.2009. Në rast se vlera e investimit të kryer nga Bleresi do të jete mbi 35% të vlerës totale të investimit pas verifikimit me ekspert ligjor kontabel të miratuar pala faktore detyrohet të paguaje pales tjetër një penahitet deri në vlerën 100% të vlerës të investimit deri në atë moment.

NENI 7.

Garancia

7.1 Pallet kanë rënë dakort që si garanci për përmbushjen e detyrimeve të rjedhura nga kjo Akt Marrëveshje të vendosin pasurinë e tyre.

NENI 8.

Perfundimi i Akt Marrëveshjes

8.1 Kjo Akt Marrëveshje konsiderohet e perfunduar kur Bleresi të ketë përmbushur plotësisht kushtet e parashikuara në këtë Akt Marrëveshje dhe deri në perfundim të investimit, përveç rasteve të zgjidhjes së parakohshme të saj Bleresi është i detyruar që brenda 15 (peshembëdhjetë) ditëve pas perfundimit të plotë të investimit sipas akt marrëveshjes të përbashket të njoftoje palën tjetër dhe të plotësojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe teknik për të kaluar në pronësi 30% të aksioneve në pronësi shoqërisë A.S.K Oil "sh.a"

NENI 9.

Zhvishja nga të Drejtat dhe Detyrimet

9.1 Pallet në Akt Marrëveshje bien dakort që me nënshkrimin e saj Shitesit nuk do të ketë asnjë të drejtë ose detyrim në lidhje me mbarevajtjen, humbjet e mundshme, detyrimet ndaj të treta që do të lindin pas nënshkrimit të kësaj Akt Marrëveshje dhe që do të rezultojnë shoqërisë „A.S.K Oil“ sh.a, si dhe të odo detyrimin të mundshëm të rezultuar nga kredi të marrë me pare apo dhe që mund të merren në të ardhmen nga Bleresi gezon të drejtën e sigurimit të financimit nëpërmjet bankave, të treta duke marrë për sipër likuidimin e tyre mbi bazën e 70% të aksioneve të tij. pallet pranojnë se do të shlyhen vetëm nga Bleresi, jashtë shoqërisë „A.S.K Oil“ sh.a e cila nuk mban asnjë përgjegjësi ligjore. Bleresi nuk mban asnjë përgjegjësi në rastet kur gjate fillimit apo vazhdimin të investimit mund të lindin konflikte nga banoret e zones, edhe pse në vertetim të Komunes Qukes Librazhd date 18.03.2011 toka dhe terreni mbi të cilën do të kryhet investimi rezulton toka shtetërore. Shitesit deklaroi se para kësaj kontrate nuk ka nënshkruar kontrata apo marrëveshje me të treta lidhur me aksionet që zoteron në shoqërinë „A.S.K Oil“ sh.a.

NENI 10.

Dhënia e Pëlqimit



investimin sipas afateve të përcaktuara në nenin 4 të kësaj Akti Marreveshje, me kushtin që HEC-i me kapacitet 7200 KW/ore, i ndodhur në aksin 3 (kuota 820-596 m), do të përfundojë dhe vihet në shfrytëzim brenda periudhës prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i kësaj Akti Marreveshje.

- 1.1.2 Palet bien dakort se si cast i përfundimit të investimit do konsiderohet momenti i marrjes së lejeve dhe venies në shfrytëzim të HEC-ve të shoqerisë "A.S.K Oil" sh.a, brenda përcaktimeve të "Kontratës Koncensionale e Formës "BOT" (Ndërtim-Operim-Transferim) Per Ndërtimin e Hidrocentraleve në Rrjedhën e Lumit Bushtrice, Rrethi i Librazhdit", me nr.2829 Rep., nr.373 Kol., date 03.09.2009.
- 1.1.3 Blerësi do të fillojë punimet në aksin 3 (kuota 820-597 mbi nivelin e detit e që i takojnë shoqerisë "A.S.K Oil" sh.a) jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kësaj Akti Marreveshje.
- 1.1.4 Blerësi do të porosis dhe blejë pajisjet hidro-mekanike, mekanike dhe elektrike, si turbinat, gjeneratorët, etj, me cilësi të lartë dhe me origjinë europiane me kushtin që ato të kenë garanci jo më pak se 15 vjetë.
- 1.1.5 Në rastet kur shoqeria "A.S.K Oil" sh.a do të vendosë të blerë kuota nga ortakët e tjerë të shoqerisë "Bushtrica Energy 2009" sh.p.k, blerja e tyre do të bëhet nga Z.Jorgo Mano për llogari të shoqerisë "A.S.K Oil" sh.a, me kushtin që z. Jorgo Mano do të paguajë 30% të vlerës së blerjes ndërsa Blerësi do paguajë 70% të vlerës së blerjes. Në këtë rast Blerësi është i detyruar të kryejë vetëm ai investimin e plotë për ndërtimin, instalimin, kompletimin me makineri pajisje, kolaudimin, marrjen e lejeve përfundimtare të shfrytëzimit të HEC-ve dhe tregimit të energjisë elektrike po dhe dhe venien në shfrytëzim të plotë të HEC-eve që do ndërtohen dhe takojnë këtyre kuotave, ndërsa 30% e investimit të kryer dhe 30% e të ardhurave të realizuara nga shfrytëzimi i HEC-eve do të takojnë Shitesit.
- 1.1.6 Me nënshkrimin e kësaj Akti Marreveshje, Jorgo Mano do të hyjë në transaksion blerje në fitim të Shoqerisë "A.S.K Oil" sh.a të 39% të kuotave në shoqerine "Bushtrica Energy 2009" shpk, që i përkasin ortakut "LNK" shpk. Në çdo rast të fillimit të punimeve shitesit duhet të jetë i pranishëm në objekt (H/C) bushtrica tek ura e vaskës duke qenë negociator me familjet Vezir Vasku, Agim Vasku për hapjen e rrugës për në objekt. Të gjitha shpenzimet do të jenë të Blerësit po ashtu gjatë fillimit të punimeve me çdo kusht duhet të jetë dhe vetë Blerësi dhe jo person përfaqësues i tij. Edhe në këtë rast investimi për ndërtimin, instalimin, kolaudimin, provimin, marrjen e lejeve dhe venien në shfrytëzim të HEC-ve të ndërtuara në këto kuota do të kryhet teresisht nga Blerësi, ndërsa 30% e investimit të kryer dhe 30% e të ardhurave të realizuara nga shfrytëzimi i këtyre HEC-eve do të takojnë Shitesit.
- 1.1.7 Prej momentit të nënshkrimit të kësaj Akti Marreveshje dhe deri në përfundim të investimit, instalimit dhe venies në efikasitet të HEC-eve, sipas përcaktimeve të bëra në "Kontratën Koncensionale e Formës "BOT" (Ndërtim-Operim-Transferim) për Ndërtimin e Hidrocentraleve në Rrjedhën e Lumit Bushtrice, Rrethi i Librazhdit", "Kontratë për Bashkëpunim të Përkohshëm të Shoqerive", statutit të shoqerive "Bushtrica Energy 2009" shpk dhe "A.S.K Oil" sh.a, investimi i plotë që do të kryhet prej datës së nënshkrimit të kësaj Akti Marreveshje deri në momentin e lidhjes së kontratës së kalimit të 70 aksioneve në fitim të Blerësit, do të realizohet me kontribute të bëra vetëm nga Blerësi, jashtë detyrimit për shoqerine "A.S.K Oil" sh.a. Në të gjitha rastet mjetet monetare dhe materiale që



- do perdoren dhe shfrytezohen per realizimin e ketij investimi do te jene te justifikueshme dhe ligjore . gjithcka duhet te jete e justifikuar
- 1.1.8 Praj nenshkrimet te kesaj Akt Marreveshje e deri ne momentin e perfundimit te investimit dhe venies ne pune te HEC-eve, pagesat e lindura ne emer dhe per llogari te shoqerise „A.S.K Oil“sh.a, perpara organit tatimor dhe perpara cdo organi tjetër shtetëror apo privat qe kane te bejne me investimet qe do kryhen pas nenshkrimet te Akt Marreveshjes,do te paguhen nga palet pergjegjese. Ne date 2 te cdo muaji Bleresi investimin do beje rakordimet per bilancin e punimeve dhe investimeve te kryera per muajin paraardhës duke i miratuar ato me nje akt te nenshkruar specialiste perpara se ato te paraqiten dhe depozitohen ne organin tatimor dhe ne cdo organ apo institucion shtetëror apo privat tjetër qe rezulton ne marrëdhënie ligjore detyruese.
 - 1.1.9 Bleresi njech investimet dhe kontributet e kryera nga Shitesit para nenshkrimet te kesaj Akt Marreveshje si investime e kontribute thelbesore dhe te vleresueshme ne masen 30% te vleres se plote te investimit qe do te kryhet dhe do te rezultojne pas nderimit, instalimit, provimit, kolaudimit, marrjes se lejese perkatese dhe venies ne shfrytezim te HEC-eve qe do rezultojne rezultojne ne shfrytezim te shoqerise „A.S.K Oil“sha.
 - 1.1.10 Pas perfundimit te investimit dhe venies ne pune te HEC-eve te nderuara per llogari te „A.S.K Oil“sh.a, 30% e te ardhurave te realizuara nga shfrytezimi i ketyre HEC-eve do ti takojë Shitesit. Ky i fundit, vetem pas periudhes se venies ne pune te HEC-ve, ka detyrimin te paguaje ne masen 30% vleren e detyrimeve te mjedhura nga zhvillimi i aktivitetit te shoqerisevetem ne pjesen qe lidhet me prodhimin dhe shitjen e energjise elektrike, te tilla si: tatim fitimi, tvsh, pagat, sigurime shoqerore dhe shendetesore, mirmbajtje. Pjesa tjetër e te ardhurave dhe te detyrimeve i takon Bleresit.
 - 1.1.11 Cdo investim tjetër i kryer jashte projektit, ne funksion te rritjes se kapacitetit prodhues nepermjet nderimit te HEC-eve te tjera te ndodhur brenda kaotave ne disponim, perdorim e shfrytezim te „A.S.K Oil“sh.a apo rrugeve alternative me ndryshime ne konstruksion e ne teknologji, do te kryhet vetem ne marreveshje ndermjet paleve. Marreveshja ndermjet paleve eshte e detyrueshme dhe ne rast se ne token dhe/ose terrenin ku shoqeria „A.S.K Oil“sh.a do te kryej investimin do te rezultojne, gjenden apo shfrytezohen pasuri te mbiteses apo te nentokes.
 - 1.1.12 Lidhja e kontratave, politikat e investimeve dhe tregimit te produktit, cmimi i shitjes se produktit te prodhuar nga HEC-et, etj, dote percaktohen detyrimisht ne marreveshje ndermjet Bleresit dhe Shitesit me akte te miratuara me pare nga keto pale te cilat do te gjejne shprehje me vendim te asamblese se aksionereve, te vertetuara ne noter, sipas perqindjeve te aksioneve te paleve.
 - 1.2 Kushtet e percaktuara ne kete nen te kesaj Akt Marreveshje perbejne kushtet thelbesore te Akt Marreveshjes. Mosrespektimi marreveshjes teresishti ketyre kushteve, con ne zgjidhjen e kontrates ndermjet te dy paleve dhe e ban kete Akt Marreveshje dhe kontraten e shitjes te aksioneve automatikisht te zgjidhur. Ne kete rast kjo Akt Marreveshje, si dhe kontrata per shitjen e aksioneve, do te konsiderohet e zgjidhur nepermjet nje njoftimi qe do u behen paleve. Zgjidhja e kontrates behet pas verifikimit dhe vleresimit te ekspertëve ligjore, qe percaktojne shkaqet per zgjidhjen e kontrates dhe pergjegjesine e paleve fajtove.



10.1 Kjo Akt Marreveshje eshte e detyrueshme per zbatim nga palet nenshkruare dhe nga trashegimtaret ligjore te ketyre paleve.

NENI 11. Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

11.1 Nese lidhur me interpretimin e termave te kesaj Akt Marreveshje apo gjate zbatimit te saj, do te lindin mosmarreveshje, atehere palet do ti zgjidhin ne mirekuptim. Nese mirekuptimi nuk arrihet, atehere ceshtja do ti referohet per zgjidhje Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Ligji i zbatueshem ne kete rast do te jete ai Shqiptar.

NENI 12. Ndryshimet e Mundshme

12.1 Cdo ndryshim i kesaj Akt Marreveshje do te behet me marreveshje te paleve, dhe vetem me akt noterial.

NENI 13. Referimi ne Dispozitat Ligjore dhe ne kete Akt Marreveshje

13.1 Per cfare nuk eshte parashikuar ne kete Akt Marreveshje, palet do ti referohen dispozitave te Kodit Civil, statutit te shoqerise „A.S.K-Oil“sh.a dhe Ligjit me Nr.9901 date 14.04.2008 „Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“.

13.2 Parashikimet ne teresi te kesaj Akt Marreveshje do te jene pjese perberese dhe te detyrueshme per tu sanksionuar edhe ne Kontraten Perfundimtare te Shitjes se Aksioneve, qe eshte nje prej qellimeve te kesaj Akt Mareveshje.

NENI 14. Pjese Perberese te Akt Marreveshjes

14.1 Bashkelidhur kesaj Akt Marreveshje, Bleresi i dorezohet nga Shitesi kopje e te gjitha dokumentacionit ligjor dhe teknik, percaktuar sipas Aneks 2.

Palet deklarojne se kjo kontrate eshte perpiluar dhe nenshkruar ne dijeni dhe ne prezence te Z. Sulejman Shkodra i datelindjes 02.07.1961, lindur dhe banues ne Kavaje, mbajtes i leternjoftimit ID Nr 028019019 dhe Z. Nazmi Bodlli i datelindjes 10.04.1957, lindur ne Seferaj Durres dhe banues ne Durres, i pajisur me leternjoftimin ID Nr 029195962.

Kjo Akt Marreveshje u hartua ne pese ekzemplare, nga te cilat kater ekzemplare i marrin palet ne kete Akt Mareveshje, nje ekzemplar mbetet ne Dhomen e Noterise Tirane.

Kjo Akt Marreveshje, pasi u lexua gjere megalit, nenshkruhet pa vetejtje nga palet dhe une Noteri e vertetoj ate konfidenca ligju.



Notari
Jorgo Mano

SHITESI

Jorgo MANO

Aksioner i vetem i A.S.K.OIL“sh.a

Jorgo Mano
Jorgo Mano



Shoqeria HOXHA

Ortak i vetem dhe Adm. Xhaxhi HOXHA

Xhaxhi HOXHA
Sulejman Shkodra



Aneks 2

1. Statuti i Shoqerise „A.S.K Oil“ sh.a;
2. Statuti i Shoqerise „Bushtrica Energy 2009“ sh.p.k;
3. Kontrate Koncesioni e Formes „BOT“ (Ndertim-Operim-Transferim) per Ndertimin e Hidrocentraleve ne Rrjedhen e Lumit Bushtrice, Rrethi Librazhd, Nr.2829 Rep., Nr.373 Kol., date 02.09.2009;
4. Kontrate per Bashkepunim te Perkohshem te Shoqerive, Nr.6067 Rep., Nr.2607 Kol., date 28.08.2009;
5. Leje Ndertimi Nr.07, date 23.03.2011, te leshuar nga Keshilli i Rregullimit te Territorit Komuna Qukes, Librazhd;
6. Vendimi i KRRT Nr.07, date 23.03.2011 „Per miratimin e destinacionit te sheshit te ndertimit dhe kondicioneve urbane te tij“, te leshuar nga Keshilli i Rregullimit te Territorit Komuna Qukes, Librazhd;
7. Planimetria e Sheshit te Ndertimit, Hidrocentrali i Bushtrices Aksi 3, Librazhd, miratuar nga Keshilli i Rregullimit te Territorit Komuna Qukes, Librazhd;
8. Vertetim „Per pronesine mbi sheshin e ndertimit ku do ndertohet Hidrocentrali, Aksi 3, nga shoqeria „A.S.K Oil“ sh.a, Nr.Prot 36/2, date 18.03.2011, te leshuar nga Komuna Qukes, Librazhd;
9. Leje „Per perdorim rezerve ujore“ Nr.VI/9, date 17.02.2010, te leshuar nga Keshilli Kombetar i Ujit, Keshilli i Basesit Ujembledhes Shkumbin-Devoll;
10. „Pelqim mjedisor“, Nr.67 Prot, date 15.03.2010, leshuar nga Agjencia Rajonale e Mjedisit, Qarku Elbasan;
11. „Dergim Oponence Teknike“, Nr.123/1 Prot., date 01 Nentor 2011, leshuar nga Instituti i Ndertimit, Departamenti i Oponencave, Rregullave Teknike dhe Standarteve, Tirane;
12. Relacion Teknik dhe Projekt Zbatimi, per Hidrocentral i Bushtrices Aksi 3, perpiluar nga shoqeria „Angerba“ sh.p.k (Projektim-Supervizion), miratuar nga Instituti i Ndertimit, Departamenti i Oponencave, Rregullave Teknike dhe Standarteve, Tirane;
13. Kodi i Rrjetit te Transmetimit dhe Projekti Elektrik;
14. Studim „Mbi leverdishtmerine Financiare per Ndertimin e Hidrocentraleve mbi Kaskaden e Lumit Bushtrice, Librazhd, me fuqi te Pergjitheshme te Instaluar 19.800 KW.